

**Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale
(21 maj 2003)**

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës

**Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të
të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale**

miratuar nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës
më 21 Maj 2003

(Sesioni i 10-të - Shtojcë e Rekomandimit 128)

Përmbajtja

Hyrje	3
Preambula	4
Parimet.....	4
Pjesa I: Politikat sektoriale	9
I.1 Politikat për sport, kohën e lirë dhe jetën shoqërore	9
I.2 Politikat për të nxitur punësimin e të rinjve dhe për të luftuar papunësinë	9
I.3 Mjedisi urban dhe vendbanimi, politikat e strehimit dhe transporti.....	10
I.4 Politikat e edukimit dhe trajnimit që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve	12
I.5 Politikat për mobilitet dhe shkëmbime eksperiencash	12
I.6 Politikat shëndetësore	13
I.7 Politikat e barazisë gjinore	14
I.8 Politikat e veçanta për zonat rurale	15
I.9 Politikat për qasjen në kulturë	15
I.10 Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin.....	16
I.11 Politikat për të luftuar dhunën dhe krimin	16
I.12 Politikat antidiskriminuese.....	17
I.13 Politikat mbi seksualitetin	18
I.14 Politikat për qasjen në të drejta dhe në ligje	18
Pjesa II: Instrumentet për pjesëmarrjen e të rinjve.....	14
II.1 Trajnimi për pjesëmarrjen e të rinjve	14
II.2 Informimi i të rinjve.....	14
II.3 Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve nëpërmjet informacionit dhe teknologjive të komunikimit	15
II.4 Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në media	15
II.5 Inkurajimi i të rinjve për të bërë punë vullnetare dhe përkushtimi i tyre për punë në dobi të komunitetit	16
II.6 Mbështetja për projektet dhe iniciativat e të rinjve.....	16
II.7 Promovimi i organizatave të të rinjve	16
II.8 Pjesëmarrja e të rinjve në organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe partitë politike...	17
Pjesa III: Pjesëmarrja institucionale e të rinjve në çështjet lokale dhe rajonale.....	18
III.1 Këshillat e rinisë, parlamentet rinore, forumet rinore	18
III.2 Mbështetja për strukturat e pjesëmarrjes së të rinjve	19

Hyrje

Themeli i asaj që do të bëhej Karta e Rishikuar Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale u hodh në konferencën e parë dhe të dytë për politikën rinore, të organizuara nga Konferenca e Përhershme e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës në Lozanë (qershor 1988) dhe në Llangollen (shtator 1991). Menjëherë pas këtyre aktiviteteve, në mars të vitit 1992, Konferenca e Përhershme miratoi Rezolutën 237 dhe nenin 22 të saj për miratimin e Kartës.

Për të festuar 10 vjetorin e Kartës Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, i cili është organ i Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me Departamentin e Këshillit të Evropës për Rininë dhe Sportin organizoi një konferencë të titulluar "Të rinjtë - Aktorët në Qytetet dhe Rajonet e tyre". Qëllimi i përgjithshëm i konferencës së organizuar në Krakov më 7 dhe 8 mars 2002 ishte të vlerësonte progresin e bërë në fushën e pjesëmarrjes së rinisë gjatë dhjetë viteve të ekzistencës së Kartës, ndërkohë që diskutoheshin mënyrat e mëtejshme të nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjve, mes të tjerave, duke përhapur praktikën më të mira. Pjesëmarrësit në konferencë miratuan Deklaratën e Krakovit nëpërmjet së cilës ata riafirmojnë se të rinjtë janë qytetarë të bashkive dhe qarqeve ku jetojnë ashtu siç çdo grup moshë tjetër dhe, si pasojë, duhet të kenë qasje në të gjitha format e pjesëmarrjes në shoqëri, si dhe përkrahin dhe rriten riafirmimin dhe promovimin e rolit të të rinjve në zhvillimin e një shoqërie demokratike, në veçanti në jetën publike lokale dhe rajonale. Për më tepër, konferenca dha një kontribut të veçantë për projektin e integruar të Këshillit të Evropës "Funksionimin e Institucioneve Demokratike".

Po ashtu, pjesëmarrësit bënë thirrje për të reaguar ndaj sfidave të reja me të cilat ballafaqohen të rinjtë në shoqërinë bashkëkohore.

Si rrjedhojë, ata i kërkuan CLRAE dhe Këshillit Konsultativ për Çështjet Rinore të Këshillit të Evropës të caktojë ekspertë për të përgatitur propozimet për ndryshimin e Kartës Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale në mënyrë që ajo t'i përgjigjet sfidave të reja të shekullit njëzetënjë, të tilla si shoqëria e informacionit dhe sigurimi urban.

Takimet e punës u realizuan në fund të vitit 2002 dhe fillim të vitit 2003. Diskutimet në këto takime punë ofruan bazat për versionin e tanishëm të Kartës. Ky version i Kartës është e ndarë në tri seksione. Seksioni i parë u ofron autoriteteve lokale dhe rajonale udhëzime për mënyrën se si të hartojnë politika që prekin të rinjtë në shumë fusha. Seksioni i dytë ofron mjete për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve. Dhe, së fundi, seksioni i tretë jep këshilla për të siguruar kushte institucionale për pjesëmarrjen e të rinjve.

Preambula

Pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendimmarrjen dhe veprimet e pushtetit lokal dhe rajonal është shumë e rëndësishme nëse duam të ndërtojmë një shoqëri më demokratike, më gjithëpërfshirëse dhe më të zhvilluar. Pjesëmarrja e një komuniteti në jetën demokratike nënkupton diçka më tepër se votimi ose kandidimi në zgjedhje, edhe pse këta janë elemente

të rëndësishme të pjesëmarrjes. Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive nënkupton të kesh të drejtë, mjete, hapësirë dhe mundësi dhe, aty ku është e nevojshme, mbështetje për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në vendimmarrje si dhe për tu angazhuar në veprime dhe aktivitete në mënyrë që të kontribuoni në ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Autoritetet lokale dhe rajonale, si autoritete më të afërta për të rinjtë, kanë një rol shumë të rëndësishëm për të luajtur në promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve. Duke vepruar kështu, autoritetet lokale dhe rajonale mund të sigurojnë që të rinjtë jo vetëm të dëgjojnë dhe të mësojnë për demokracinë dhe qytetarinë, por të kenë mundësinë për ta praktikuar atë. Megjithatë, pjesëmarrja e të rinjve nuk ka të bëjë vetëm me të krijuarit e qytetarëve aktivë, ose me ndërtimin e demokracisë për të ardhmen. Nëse pjesëmarrja është kuptimplote për të rinjtë, është shumë e rëndësishme që ata të mund ndikojnë dhe të marrin pjesë aktivisht në vendimet dhe veprimet e organeve lokale kur ata janë ende të rinj, dhe jo vetëm në një fazë të mëvonshme të jetës së tyre.

Kur autoritetet lokale dhe rajonale mbështesin dhe nxisin pjesëmarrjen e të rinjve, ata kontribuojnë dhe për integrimin social të të rinjve, duke ndihmuar që të rinjtë të merren jo vetëm me sfidat dhe presionet e tyre, por edhe me sfidat e një shoqërie moderne ku shpesh mbizotëron anonimiteti dhe individualizmi. Megjithatë, në mënyrë që pjesëmarrja e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale të jetë e suksesshme, e qëndrueshme dhe kuptimplotë[duhet më tepër se zhvillim apo ristrukturim i sistemeve politike apo administrative. Çdo politikë ose veprim e projektuar për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve duhet të sigurojë se mjedisi kulturor i respekton të rinjtë dhe se merr po ashtu parasysh nevojat e ndryshme, rrethanat dhe aspiratat e tyre. Përgjatë këtij procesi duhet të përfshihen edhe disa elemente të argëtimit dhe kënaqësisë.

Parimet

1. Pjesëmarrja e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale duhet të jetë pjesë e politikës globale të pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike, siç është parashtruar në Rekomandimin Rec (2001) 19 e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike lokale.
2. Autoritetet lokale dhe rajonale janë të bindur se të gjitha politikat sektoriale duhet të kenë dimension për të rinjve. Prandaj ata angazhohen për t'ju përmbajtur dispozitave të kësaj Karte dhe për të zbatuar format e ndryshme të pjesëmarrjes, të cilat i ndjekin në konsultim dhe bashkëpunim me të rinjtë dhe përfaqësuesit e tyre.
3. Parimet dhe format e ndryshme të pjesëmarrjes të promovuara në këtë Kartë zbatohen për të gjithë të rinjtë pa diskriminim. Për të arritur këtë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet promovimit të pjesëmarrjes në jetën lokale dhe rajonale të të rinjve nga sektorët në nevojë të shoqërisë dhe pakicat etnike, kombëtare, shoqërore, seksuale, kulturore, fetare dhe gjuhësore.

Pjesa I: Politikat sektoriale

1.1 Politikat për sportin, kohën e lirë dhe jetën shoqërore

4. Autoritetet lokale dhe rajonale duhet të mbështesin aktivitetet socio-kulturore, të

organizuara nga shoqatat dhe organizatat rinore, grupet e të rinjve dhe qendrat e komunitetit, të cilat, së bashku me familjen, shkollën ose punën, janë njëra nga shtyllat e kohezionit social në bashki ose rajon, të cilat përbëjnë një kanal ideale për pjesëmarrjen e të rinjve dhe zbatimin e politikave rinore në fushën e sportit, kulturës, zejeve dhe tregtisë, formave artistike dhe formave të tjera të krijimit dhe të shprehjes, si dhe në fushën e veprimit social.

5. Me qëllim që të zhvillohet sektori i shoqatave lokale dhe rajonale të të rinjve, autoritetet lokale dhe rajonale, përmes masave të përshtatshme, duhet të japin mbështetjen e tyre, në veçanti për organizatat që trajnojnë ndihmësit dhe udhëheqësit e klubeve dhe organizatave rinore, si dhe personave që punojnë me të rinjtë, të cilët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në jetën lokale dhe rajonale.

6. Autoritetet lokale dhe rajonale duhet të inkurajojnë shoqatat për të promovuar pjesëmarrjen aktive të të rinjve në organet e tyre statutore.

1.2 Politika për të nxitur punësimin e të rinjve dhe për të luftuar papunësinë

7. Kushtet ekonomike dhe shoqërore që përjetojnë të rinjtë ndikojnë në vullnetin dhe aftësinë e tyre për të marrë pjesë në komunitetin e tyre lokal. Kur të rinjtë janë të papunë, ose jetojnë në varfëri, atëherë ka pak të ngjarë që ata të kenë dëshirë, burime dhe mbështetje shoqërore për të qenë qytetarë aktivë në jetën lokale dhe rajonale. Të rinjtë e papunë ka të ngjarë të jenë ndër më të përjashtuarit në shoqëri. Për këtë arsye autoritetet lokale dhe rajonale duhet të zhvillojnë politika dhe të promovojnë iniciativa për të zvogëluar papunësinë e të rinjve.

8. Prandaj, autoritetet lokale dhe rajonale duhet të:

i. zhvillojnë politika dhe programe të përqendruara tek të rinjtë (duke përfshirë edhe të rinjtë e papunë ose në rrezik të mbesin pa papunë), punëdhënësit lokalë, sindikatat, organet arsimore, trajnuese dhe të punësimit dhe organizata të të rinjve për të trajtuar shkaqet e papunësisë së të rinjve dhe nxitjen e mundësive të punësimit për të rinjtë;

ii. krijojnë qendra lokale të punësimit për të siguruar ndihmë nga specialistët dhe mbështetjen për të rinjtë e papunë, në mënyrë që ata të gjejnë një punës domethënëse dhe të qëndrueshme. Të rinjtë e papunë duhet të kenë të drejtë të përfshihen në menaxhimin e këtyre qendrave nëse dëshirojnë;

iii. mbështesin krijimin e bizneseve, ndërmarrjeve dhe kooperativave nga të rinjtë, apo grupe të të rinjve duke ofruar financim dhe mbështetje të tjera, të tilla si ambiente, pajisjet, trajnimet dhe këshillime profesionale;

iv. inkurajojnë eksperimentimin nga të rinjve me ekonominë shoqërore, iniciativat ose sipërmarrjet vetëmbështetëse në komunitet.

1.3 Mjedis urban dhe vendbanimi, politikat e strehimit dhe transporti

9. Sëbashku me përfaqësues të organizatave rinore, autoritetet lokale dhe rajonale

duhet të krijojnë kushte për zhvillimin e një politike të mjedisit urban të bazuar në një mjedis jetese më të integruar dhe më pak të fragmentarizuar, i cili është i favorshëm për ndërveprim shoqëror dhe për zhvillimin e hapësirave publike me cilësi të lartë.

10. Organet vendore dhe rajonale duhet të ndjekin ato politika mjedisore urbane dhe të strehimit të cilat i përfshijnë drejtpërdrejtë të rinjtë në konsultime me të zgjedhurit vendorë ose rajonalë, vendimmarrësit e çështjeve ekonomike, drejtuesit e shoqatave dhe arkitektët. Qëllimi i tyre është:

i. hartimi i programeve për një mjedis më të favorshëm dhe më të përshtatshëm për vetëplotësim personal dhe zhvillimi i solidaritetit të vërtetë ndërmjet brezave;

ii. zhvillimi i një politike të përbashkët për mjedisin urban, e cila merr parasysh realitetin shoqëror dhe ndërkulturor të banorëve në hartimin e banesave dhe/ose programeve të rinovimit të banesave.

11. Në bashkëpunim të ngushtë me organizatat rinore, organizatat e qiramarrësve dhe/ose organizatat e konsumatorëve, agjencitë e banesave sociale dhe të punonjësve socialë, autoritetet lokale dhe rajonale duhet të promovojnë zhvillimin, ose të zhvillojnë në kuadër të strukturave ekzistuese shoqërore:

i. shërbime lokale informacioni për strehimin për të rinjtë;

ii. skemat lokale (p.sh. kredi me kosto të ulët, sistemet e garantuara të qirasë) për të ndihmuar të rinjtë për të pasur shtëpi.

12. Lëvizja e të rinjve bëhet e mundur nëpërmjet përdorimit më të lehtë të transportit publik, në të cilin ata janë përdoruesit kryesorë. Kjo lëvizshmëri është e domosdoshme për pjesëmarrjen në jetën shoqërore dhe për të qenë qytetarë në kuptimin e plotë të fjalës.

13. Si rezultat, të rinjtë duhet të përfshihen në organizimin e transportit publik si në nivelin lokal ashtu edhe në atë rajonal. Për ata të rinj të cilët janë në pozitë më të pafavorshme për të udhëtuar, duhet të bëhet përshtatja e tarifave në mënyrë që atyre t'u mundësohet ky shërbim.

14. Në zonat rurale, mobiliteti dhe transporti janë një domosdoshmëri themelore për cilësinë e jetës dhe jo vetëm nevojë për të lehtësuar pjesëmarrjen. Prandaj, autoritetet lokale dhe rajonale duhet të mbështesin iniciativat që kërkojnë të ofrojnë shërbime të transportit rural (publike ose private, individuale ose kolektive) dhe të rrisin mobilitetin në zonat rurale për grupet të tilla si të rinjtë, të cilët aktualisht janë të përjashtuar për shkak të mungesës së mjeteve e transportit.

I.4 Politikat e edukimit dhe trajnimit të cilat nxisin pjesëmarrjen e të rinjve

15. Shkolla është një institucion në të cilin të rinjtë jo vetëm kalojnë një pjesë të konsiderueshme të jetës së tyre dhe i nënshtrohen një programi formal edukimi, por edhe vendi ku formësohen shumë prej pikëpamjeve dhe perspektivave të tyre mbi jetën. Është shumë e rëndësishme që të rinjtë të mësojnë për pjesëmarrjen dhe demokracinë ndërsa janë ende në shkollë, dhe që kurset për demokraci, pjesëmarrje dhe qytetari të jenë të pajisura me burimet e nevojshme. Megjithatë shkolla duhet të jetë vendi ku të rinjtë ta ndiejnë demokracinë në veprim dhe ku pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje mbështetet, promovohet dhe konsiderohet si efektive.

Për këto arsye:

i. autoritetet lokale dhe rajonale duhet të inkurajojnë aktivisht pjesëmarrjen e të rinjve në jetën e shkollës. Ata duhet të ofrojnë mbështetje financiare dhe mbështetje të tjera, siç janë hapësira për mbledhje, për t'u mundësuar të rinjve që të themelojnë shoqata demokratike nxënësish në shkolla. Këto shoqata duhet të jenë të pavarura dhe vetëqeverisëse, dhe nëse dëshirohet nga nxënësit, ato duhet të kenë të drejtë të marrin pjesë në vendimet në lidhje me menaxhimin e shkollës në bashkëpunim me mësuesit dhe organet drejtuese të shkollës.

ii. Atëherë kur organet lokale dhe rajonale janë përgjegjëse për kurrikulat e shkollës, ata duhet të sigurojnë konsultimin e vazhdueshëm të nxënësve dhe shoqatave të tyre për kurrikulat dhe zhvillimin e tyre. Po ashtu, këto organe duhet të sigurojnë përfshirjen e edukimit qytetar dhe politik në kurrikulat shkollë dhe ofrimin e rëndësishëm dhe burimeve të nevojshme për programet arsimore për të gjithë nxënësit .

I.5 Politikat për mobilitet dhe shkëmbime

16. Organet vendore dhe rajonale duhet të mbështesin ato shoqata ose grupe të cilat favorizojnë mobilitetin e të rinjve (punëtorëve të rinj, studentëve, ose vullnetarëve) nëpërmjet politikave të shkëmbimit, dhe të zhvillojnë politikat e krijimit të rrjeteve sociale dhe të vetëdijes së qytetarisë evropiane.

17. Organet vendore dhe rajonale duhet të inkurajojnë të rinjtë, organizatat dhe shkollat e tyre të marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet ndërkombëtare të binjakëzimit, të gjitha llojet e shkëmbimeve dhe në rrjetet evropiane. Këto organe duhet të jenë gati për t'i dhënë të rinjve mbështetje financiare, në mënyrë që të promovojnë mësimin e gjuhës, shkëmbimet ndërkulturore, si dhe shkëmbimet e përvojës.

18. Organet vendore duhet të përfshijnë të rinjtë dhe/ose përfaqësuesit e tyre në komitetet e binjakëzimit dhe në organet e tjera përgjegjëse për zbatimin e këtyre ndërveprimeve.

I.6 Politikat shëndetësore

19. Me qëllimin e nxitjes së krijimit dhe zbatimit të projekteve që vijnë nga të rinjtë dhe për të promovuar si zhvillimin e konceptit shëndetësor në përgjithësi dhe dinamikën e jetës e komunitetit, organet vendore dhe rajonale duhet të krijojnë ose zhvillojnë mekanizma institucionalë për konsultime ndërmjet organizatave rinore, përfaqësuesve të zgjedhur dhe të gjitha grupeve shoqërore e profesionale që merren me mirëqenien sociale dhe promovimin e shëndetit.

20. Të ballafaquar me të këqijat e duhanit, alkoolit dhe abuzimit të drogës ndërmjet të rinjve, organet vendore dhe rajonale duhet të paraqesin, zhvillojnë ose të promovojnë së bashku me përfaqësues të organizatave të të rinjve dhe të shërbimeve shëndetësore, politikat lokale të informimit dhe ambiente këshillimesh për të rinjtë të prekur nga këto probleme, si dhe politika të veçanta të trajnimit për punonjësit e rinj socialë, për vullnetarët dhe për drejtuesit e organizatave që merren me strategji parandaluese dhe rehabilituese për të rinjtë në fjalë.

21. Duke pasur parasysh rritjen e numrit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, organet vendore dhe rajonale duhet të intensifikojnë fushatat e informimit dhe masat parandaluese të përqendruar tek të rinjtë, duke promovuar në komunitet shpirtin e solidaritetit dhe vendosjen e marrëdhënieve shoqërore në të cilat nuk ka vend për gjykime morale dhe për ndarje. Të rinjtë dhe përfaqësuesit e organizatave rinore lokale dhe të shërbimeve shëndetësore duhet të përfshihen nga afër në hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve informative dhe vepruese.

I.7 Politikat e barazisë gjinore

22. Si pjesë e politikave të tyre për të krijuar kushte optimale për pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në çështjet lokale dhe rajonale, organet vendore dhe rajonale duhet të ndërmarrin veprime afirmative që të mbështesin qasjen e femrave dhe meshkujve të rinj në pozita me përgjegjësi në jetën profesionale, shoqata, politikë dhe në organet vendore dhe rajonale.

23. Brenda kufijve të kompetencave të tyre, organet vendore dhe rajonale duhet të promovojnë, që nga fëmijëria e hershme e tutje, një politikë edukative për barazinë midis femrave dhe meshkujve.

24. Për të promovuar një politikë të barazisë ndërmjet femrave dhe meshkujve, organet vendore dhe rajonale duhet të:

i. hartojnë një plan afatmesëm me qëllim të eliminimit të pabarazive ndërmjet femrave të reja dhe meshkujve të rinj;

ii. zbatojnë dhe vlerësojnë masat që promovojnë mundësi të barabarta për vajzat dhe gratë e reja.

25. Për të arritur këtë qëllim, këto politika duhet në mënyrë të veçantë t'u mundësojnë vajzave dhe grave të reja:

- i. të marrin informacion të veçantë mbi kurset e trajnimit që çojnë në kualifikimet profesionale;
- ii. të përvetësojnë aftësi profesionale duke ofruar grante dhe kurse të veçanta të studimit për profesione, duke përfshirë ato që tradicionalisht ushtrohen nga meshkujt;
- iii. të trajnohen në bërjen e punëve publike duke ua besuar atyre përgjegjësitë në nivelin më të lartë, mbi bazën e një kuote për vende të tilla pune për femra;
- iv. prezantimin e masave financiare për shërbimet shoqërore të cilat ndihmojnë vajzat dhe gratë e reja.

I.8 Politikat e veçantë për zonat rurale

26. Organet vendore dhe rajonale duhet të marrin parasysh nevojat e ndryshme të të rinjve në zonat rurale kur të zhvillojnë apo ndër marrin veprime dhe aktivitete për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve. Prandaj, ata duhet të:

- i. të sigurojnë që edukimi, punësimi, banimi, transporti dhe politikat e tjera sektoriale të reflektojnë dhe të trajtojnë nevojat e veçanta të të rinjve që jetojnë në zonat rurale. Këto politika duhet t'u vijjnë në ndihmë të rinjve që dëshirojnë të jetojnë në zonat rurale. Të rinjtë që jetojnë në zonat rurale nuk duhet të kenë ose të presin një nivel më të ulët të shërbimeve dhe masave shoqërore nga ata që jetojnë në zonat urbane;
- ii. të ofrojnë mbështetje financiare dhe mbështetje të tjera për organizatat rinore dhe organizatat e tjera të komunitetit që janë aktive në zonat rurale. Këto organizata mund të stimulojnë jetën shoqërore dhe kulturore në komunitetet rurale dhe mund të jenë një mjet i rëndësishëm shoqëror për të rinjtë. Rinia dhe organizatat tjera të komunitetit jo vetëm që luajnë një rol të rëndësishëm në inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve, por ato mund të rrisin edhe cilësinë e jetës dhe të luftojnë probleme, të tilla si izolimi rural.

I.9 Politikat për qasjen në kulturë

27. Arti dhe kultura ekzistojnë në forma që janë si të shumëfishta ashtu edhe vazhdimisht në ndryshim, sipas shijes, vendit dhe periudhës. Megjithatë, ata janë pjesë e trashëgimisë kolektive dhe personale të së kaluarës, së tashmes dhe të ardhmes, në të cilat kontribuojnë brezat e njëpasnjëshëm. Ata janë në një mënyrë, pasqyrim i çdo shoqërie. Të rinjtë, nëpërmjet praktikimit të kulturës dhe kapaciteteve të tyre për iniciativë, kërkim dhe novacion, ndërtojnë dhe luajnë një rol në këto zhvillime kulturore. Prandaj është e rëndësishme për t'u

mundësuar atyre qasja në kulturë në të gjitha format e saj dhe për të promovuar mundësitë e tyre për veprimtari krijuese, duke përfshirë dhe sferat e reja.

28. Prandaj organet vendore dhe rajonale, në bashkëpunim me të rinjtë dhe organizatat e tyre, duhet të përvetëjnë politikat e hartuara për t'u mundësuar atyre të bëhen aktorë të kulturës, me qasje në njohuri, praktikim të kulturës dhe të veprimtarisë krijuese duke përdorur metodat e hartuara për këtë qëllim.

1.10 Politikat për zhvillim të qëndrueshëm dhe për mjedisin

29. Përballë një përkeqësim gjithnjë e më e madh të mjedisit, organet vendore dhe rajonale duhet të japin mbështetje financiare për projektet edukative në shkolla dhe shoqata, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për problemet mjedisore.

30. Të vetëdijshëm se problemet e mjedisit janë shqetësim kryesor për të rinjtë të cilët do të jenë të detyruar në të ardhmen që të përballen me pasojat e gabimeve të së shkuarës, organet vendore dhe rajonale duhet të mbështesin aktivitetet dhe projektet që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat përfshijnë të rinjtë dhe organizatat e tyre.

1.11 Politikat për të luftuar dhunën dhe krimin

31. Duke pasur parasysh se të rinjtë janë shpesh viktima të krimit dhe të dhunës dhe duke njohur nevojën e gjetjes së përgjigjeve të përshtatshme ndaj krimit dhe dhunës në shoqërinë bashkëkohore, si dhe nevojën për të përfshirë direkt të rinjtë në luftimin e këtyre problemeve;

32. Organet vendore dhe rajonale duhet të:

i. përfshijnë të rinjtë në këshillat e parandalimit të krimit, aty ku këto ekzistojnë;

ii. punojnë në mënyrë të veçantë me të rinjtë të cilët rrezikojnë të përfshihen në krim ose të cilët tashmë janë të përfshirë në krim;

iii. luftojnë dhunën raciste me të gjitha mjetet në dispozicion;

iv. trajtojnë të gjitha format e dhunës në shkolla. Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me të gjithë aktorët përkatës, të tillë si autoritetet arsimore dhe policore, mësuesit, prindërit dhe vetë të rinjtë;

v. kontribuojnë në krijimin e rrjeteve të shoqatave dhe të projekteve që promovojnë mungesën e dhunës dhe tolerancën si në shkollë ashtu edhe jashtë saj;

vi. bëjnë të pamundurën për të mbrojtur të rinjtë nga shfrytëzimi seksual, abuzimi, apo format e tjera të keqtrajtimit, dhe të sigurojnë struktura që ofrojnë mbështetje psikologjike dhe materiale si dhe konsultime konfidenciale për viktimat.

33. Në zbatimin e pikës së mësipërme, organet vendore dhe rajonale kontribuojnë drejt ndërtimit të një klime besimi dhe respekti ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve publike, të tilla si policia.

I.12 Politikat antidiskriminuese

34. Organet vendore dhe rajonale duhet të promovojnë aktivisht të drejtat e njeriut dhe masat për të luftuar diskriminimin kundër pakicave (përfshirë anëtarët e tyre të rinj), ose kundër të rinjve me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të popullsisë që mund të vuajnë nga diskriminimi, dhe duhet të promovojnë zhvillimin e komuniteteve multikulturore përmes integritit të pakicave duke marrë parasysh nevojat e tyre të ndryshme si zakonet, kulturën dhe stilet e jetës.

35. Në lidhje me këtë, organet vendore dhe rajonale duhet të:

i. miratojnë ose të përmirësojnë ligjet antidiskriminuese në mënyrë që të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë qytetarët në vendet publike, në trajnim profesional, shkollim, banim, aktivitete kulturore dhe në fushat e tjera të jetës. Një qasje e tillë duhet të monitorohet dhe të garantohet nga organet e përbashkëta me përfaqësues të qeverisjes vendore, përfaqësues të pakicave dhe vetë të rinjtë;

ii. nxisin dialogun ndërfaqësor, kulturor, edukimin antiracist dhe edukimin kundër diskriminimit, si pjesë e kurrikulës shkollore.

I.13 Politikat mbi seksualitetin

36. Gjatë kalimit të tyre nga vartësia femërore në familje, shkollë, bashkësi fetare ose "autoritete" të tjera drejtë një jete autonome të të rriturve, ata mund të përballen me një sërë pyetjesh lidhur me marrëdhëniet e tyre personale (brenda familjes ose rrethit të ngushtë, me moshatarët e tyre, me shokët ose partnerin e tyre). Shfaqja dhe ushtrimi i seksualitetit të tyre nuk është gjithmonë i lehtë, edhe në qoftë se ata nuk janë të gatshëm ta pranojnë këtë. Përveç kësaj, ekziston një mungesë e vazhdueshme njohurish rreth çështjeve të shëndetit seksual dhe mosbesimit ndaj qëndrimeve zyrtare lidhur me rreziqet e sjelljeve të caktuara seksuale.

37. Në mënyrë që të ndihmojnë të rinjve të gjejnë rrugën e tyre në këtë fushë, duke i udhëzuar ata drejt një jete të shëndetshme dhe përmbushjeve emocionale, organet vendore dhe rajonale në bashkëpunim me prindërit, shkollat dhe organizatat e specializuara në këtë fushë, duhet të promovojnë dhe të mbështesin:

i. edukimin seksual në shkolla;

ii. organizatat dhe shërbimet që ofrojnë informacion në lidhje me marrëdhëniet dhe metodat seksuale si dhe me planifikimin familjar;

iii. punën në grupe moshatarësh në këtë fushë.

38. Të rinjtë duhet të lidhen në mënyrë aktive me planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e informacioneve si dhe shërbimeve të tjera që drejtohen për të rinjtë në këtë fushë.

1.14 Politikat për qasjen në të drejta dhe në ligj

39. Në mënyrë që të jetojnë së bashku, shoqëritë bazohen në rregulla të cilat duhet të respektohet nga të gjithë. Në shoqëritë demokratike, këto rregulla diskutohen dhe miratohen nga përfaqësuesit e zgjedhur nga qytetarët dhe marrin shprehje konkrete, sidomos në tekstet legjislative të cilat u caktojnë të drejta dhe detyrime të gjithë personave.

40. Duke qenë se numri i këtyre teksteve ligjore është gjithmonë në rritje, bëhet gjithnjë e më të vështirë për një individ që të njohë, respektojë dhe të zbatojë këto tekste ligjore duke krijuar kështu dallime ndërmjet qytetarëve. Të rinjtë natyrisht janë më të shqetësuarit për këtë fenomen.

41. Organet vendore dhe rajonale për këtë arsye duhet t'ua lehtësojë të rinjve qasjen në të drejtat e tyre:

i. duke zhvilluar njohuritë e tyre nëpërmjet shpërndarjes së informacionit, sidomos në shkolla, grupet e bashkëmoshatarëve dhe shërbimet informative;

ii. duke zbatuar të drejtat e tyre përmes mbështetjes së shërbimeve të hartuara për të punuar së bashku me të rinjtë që e dëshirojnë këtë;

iii. duke u bërë të mundur të rinjve të marrin pjesë në hartimin e rregullave reja.

Pjesa II: Instrumentet për pjesëmarrjen e të rinjve

42. Në mënyrë që të arrihet pjesëmarrja e vërtetë e të rinjve, në dispozicion të tyre vihen disa instrumentesh. Kjo përfshin zhvillimin e trajnimeve mbi pjesëmarrjen e të rinjve, mbajtja e tyre të informuar, ofrimin e mjeteve të komunikimit, mbështetjen e projekteve të tyre, njohjen dhe dhënien e një profil më të lartë përkushtimit të të rinjve në kauzën e komunitetit dhe punën vullnetare. Pjesëmarrja merr kuptimin e plotë vetëm kur njihet roli i të rinjve në partitë politike, sindikata dhe shoqata dhe, mbi të gjitha, kur bëhet përpjekje për të promovuar shoqatat rinore të formuara nga vetë të rinjtë.

II.1 Trajnimi për pjesëmarrjen e të rinjve

43. Organet vendore dhe rajonale, të vetëdijshëm për rolin dominues që luan shkolla në jetën e të rinjve, duhet të ofrojnë në mjedisin e shkollës mbështetje dhe trajnime mbi pjesëmarrjen e të rinjve, edukim mbi të drejtat e njeriut dhe mësim informal. Ata duhet gjithashtu të ofrojnë trajnime dhe mbështetje për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën e përbashkët dhe në komunitetin e tyre lokal duke promovuar:

- i. trajnime profesionale për mësuesit dhe punëtorëve që punojnë me të rinjtë në praktikën e pjesëmarrjes së të rinjve;
- ii. të gjitha format e pjesëmarrjes së nxënësve në shkolla;
- iii. programet e edukimit qytetar në shkolla;
- iv. arsimim në grupe bashkëmoshatarësh, duke ofruar hapësira dhe mjete të nevojshme dhe duke mbështetur shkëmbimin e praktikave të mira.

II.2 Informimi i të rinjve

44. Informacioni është shpesh çelësi për pjesëmarrje, dhe e drejta e rinjve që të kenë qasje në informacion në lidhje me mundësitë dhe çështjet që u përkasin atyre njihet gjithnjë e më shumë në dokumentet zyrtare evropiane dhe ndërkombëtare¹, dhe jo vetëm në kontekstin e jetës vendore dhe rajonale.

45. Në mënyrë që të marrin pjesë në aktivitete dhe në jetën e komunitetit të tyre, ose të përfitojnë nga shërbimet dhe mundësitë që u dedikohen atyre, të rinjtë duhet të kenë njohuri për ato. Pjesëmarrja në aktivitetet dhe projektet me interes për të rinjtë dhe që ata vetë i organizojnë është shpesh një hap në procesin e inkurajimit të tyre në përfshirjen e tyre më të thellë në komunitet, duke përfshirë edhe në jetën politike të komunitetit.

¹ Shih për shembull Rekomandimin Nr R (90) 7 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me informacionin dhe këshillim për të rinjtë në Evropë, miratuar më 21 shkurt 1990

46. Për këtë arsye, organet vendore dhe rajonale duhet të mbështesin dhe të përmirësojnë informacionin ekzistues dhe qendrat këshilluese për të rinjtë, në mënyrë që të sigurohen se ato ofrojnë shërbime cilësore që përmbushin nevojat e shprehura nga të rinjtë. Kur qendrat e tilla nuk ekzistojnë, organet vendore dhe rajonale dhe aktorët e tjerë përkatës duhet të promovojnë dhe të ndihmojnë krijimin e shërbimeve të përshtatshme për informim për të rinjtë, ndër të tjera, përmes strukturave ekzistuese siç janë shkollat, shërbimet për të rinjtë dhe bibliotekat. Duhet të ndërmerren masa specifike për të plotësuar nevojat për informacion të grupeve të të rinjve të cilët kanë vështirësi në marrjen e informacionit (barrierat gjuhësore, mungesa e përdorimit të internetit, etj.).

47. Shërbimet e informacionit për të rinjtë duhet t'u përmbahen disa parimeve dhe standardeve profesionale². Inkurajohen organet publike për të garantuar standarde të tilla dhe për të promovuar përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, aty ku është e mundur, në përputhje me një sërë masash dhe standardesh kombëtare (ose rajonale) të përcaktuara. Të rinjtë duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e aktiviteteve dhe produkteve të qendrave/shërbimeve të informacionit të të rinjve dhe të përfaqësohen në organet e tyre qeverisëse.

II.3 Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve nëpërmjet informacionit dhe teknologjive të komunikimit

48. Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit mund të ofrojnë mundësi të reja për të informuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e të rinjve. Ato mund të përdoren për të shkëmbyer një shumëllojshmëri të gjerë të informacionit, dhe në sajë të ndëraktivitetit të tyre, ato mundësojnë rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve. Prandaj organet vendore dhe rajonale duhet t'i përdorin këto teknologji në politikatat e tyre të informimit dhe pjesëmarrjes, me kusht që qasja në to të jetë e garantuar për të gjithë të rinjtë.

II.4 Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në media

Përderisa të rinjtë janë konsumatorët kryesorë të mediave, ata mund të bëhen edhe aktorë në këtë fushë duke rritur mundësitë për të shprehur vetveten dhe të marrin pjesë në prodhimin e informacionit të ofruar nga mediat. Nëpërmjet mënyrës së veprimit të tyre me subjekte të caktuara ata mundësojnë që informacione të ndryshme dhe shpesh më të qasshme t'u ofrohen bashkëmoshatarëve të tyre. Kjo pjesëmarrje u mundëson po ashtu të rinjve të kuptojnë mënyrën e ndërtimit të informacionit dhe të zhvillojnë zotësinë e nevojshme kritike.

50. Prandaj organet vendore dhe rajonale duhet të mbështesin krijimin dhe funksionimin e mediave (radios, televizionit, si dhe shtypit të shkruar dhe elektronik, etj) të zhvilluar nga dhe për të rinjtë, si dhe programet përkatëse të trajnimit.

² Shih, për shembull Kartën Evropiane për Informimin e të Rinjve, miratuar nga Agjencia për Informin dhe Këshillim të të Rinjve (ERYICA).

II.5 Inkurajimi i të rinjve për të bërë punë vullnetare dhe përkushtimi i tyre për punë në dobi të komunitetit

51. Të rinjtë duhet të përkrahen dhe të inkurajohen që të angazhohen në veprimtari vullnetare. Në kohën kur të rinjtë janë nën një presion në rritje për të performuar dhe për të pasur sukses si individë në arsim dhe në botën e punës, është e rëndësishme të promovohet vullnetarizmi. Prandaj, organet vendore dhe rajonale duhet të:

i. mbështesin krijimin e qendrave vullnetare dhe të zhvillojnë nismat që synojnë mbështetjen dhe promovimin e përfshirjes së të rinjve në veprimtari vullnetare, siç janë fushatat informuese dhe promovuese.

ii., të zhvillojnë sisteme të cilat njohin dhe vërtetojnë aktivitetet vullnetare në sistemin e edukimit formal dhe në punësim, në bashkëpunim me të rinjtë, organizatat vullnetare, autoritetet arsimore dhe punëdhënësit.

II.6 Mbështetja për projektet dhe iniciativat e të rinjve

52. Përmes shpresave dhe dëshirave të tyre, të rinjtë kanë shumë ide të cilat mund të transformohen në projekte dhe aktivitete lokale që janë të dobishme për të gjithë. Duke u dhënë mbështetjen e duhur, këto projekte, me sukseset dhe dështimet e tyre, mund t'i ndihmojnë të rinjtë që të zhvillojnë ndjenjën e tyre të përgjegjësisë dhe autonomisë, duke u bërë kështu aktorë socialë. Për këtë arsye, organet vendore dhe rajonale duhet të lehtësojnë zbatimin e këtyre projekteve, qofshin ato në shkallë të vogël apo në shkallë të gjerë, duke i mundësuar të rinjve të shoqërohen nga profesionistë në ekzekutimin e tyre dhe të kenë ndihmë financiare, materiale dhe teknike.

II.7 Promovimi i organizatave të të rinjve

53. Organizatat rinore janë unike, pasi ato janë të përqendruara kryesisht në pasqyrimin e pikëpamjeve dhe u shërbejnë nevojave dhe interesave të të rinjve. Ato ofrojnë po ashtu një hapësirë ku të rinjtë mund të mësojnë dhe të ushtrojnë mundësitë dhe sfidat për pjesëmarrje në vendime dhe veprime me të rinjtë e tjerë. Ata mund të jenë organizata të strukturuar, ose grupe joformale të të rinjve. Është e rëndësishme që të rinjtë të kenë mundësinë për të bëhen pjesë e organizatës që ata dëshirojnë në komunitetin e tyre, nëse ata e dëshirojnë këtë gjë. Prandaj,

i. organet vendore dhe rajonale duhet të kenë një buxhet të veçantë të përcaktuar vetëm për mbështetjen e organizatave të të rinjve që drejtojnë aktivitete ose ofrojnë shërbime, ose veprojnë si zë i të rinjve në komunitet dhe veprojnë në emër të tyre. Preferenca duhet të kenë organizatat që drejtohen nga të rinjtë dhe janë për të rinjtë dhe/ose kanë përfshirë politika dhe sisteme për të mundësuar pjesëmarrje aktive të të rinjve;

ii. organet vendore dhe rajonale duhet të zhvillojnë parimet e bashkëmenaxhimit dhe sistemin

e vendimmarrjes së Këshillit të Evropës në bashkëpunim me të rinjtë dhe organizatat rinore në sferat e politikave me interes për të rinjtë. Është e rëndësishme që aty ku është inkorporuar një strukturë e tillë bashkëmenaxhimi, të rinjtë dhe organizatat rinore të respektohen si partnerë të plotë dhe të kenë mundësinë të zgjedhin të mos marrin pjesë në qoftë se ata dëshirojnë.

II.8 Pjesëmarrja e të rinjve në organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe partitë politike

54. Një sektor joqeveritar i gjallë, i pavarur dhe aktiv është element i rëndësishëm i çdo shoqërie të vërtetë demokratike. Është gjithashtu e rëndësishme që sektorët e tjerë të shoqërisë civile, të tilla si partitë politike, të jenë të fortë dhe aktivë në nivel vendor dhe rajonal. Pjesëmarrja në jetën demokratike të çdo vendi, rajoni apo lokaliteti nënkupton më shumë se votimi një herë në disa vjet. Kjo është arsyeja pse pjesëmarrja në OJQ-të dhe partitë politike është aq e rëndësishme, sepse ato ndihmojnë qytetarët të jenë të përfshirë dhe të kenë ndikimin e tyre të vazhdueshëm në vendimet dhe veprimet e marra. Prandaj është e rëndësishme që të rinjtë të inkurajohen dhe të mbështeten për të marrë pjesë në jetën shoqërore në komunitetet e tyre.

55. Organet vendore dhe rajonale duhet të sigurojnë burime financiare dhe burime të tjera për OJQ-të të cilat promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitetet e tyre si dhe në strukturat dhe procedurat demokratike vendimmarrëse.

56. Organet vendore dhe rajonale, në partneritet me partitë politike dhe në mënyrë jo-partiake, duhet të nxisin përfshirjen e të rinjve në sistemin e partive politike në përgjithësi, dhe të mbështesin veprime të veçanta, siç është trajnimi, në veçanti.

Pjesa III: Pjesëmarrja institucionale e të rinjve në çështjet lokale dhe rajonale

57. Në mënyrë që të kryejnë politikat sektoriale të përcaktuara në pjesën e parë, organet vendore dhe rajonale duhet të angazhohen për të krijuar strukturat ose organizimet përkatëse për të bërë të mundur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimet dhe debatet që kanë të bëjnë me të rinjtë.

58. Këto struktura do të marrin forma të ndryshme sipas nivelit në të cilin ato janë themeluar, qoftë ai i një fshati, një qyteti, një lagje urbane brenda një qyteti, apo edhe një rajoni. Ato duhet të krijojnë kushte për dialog të mirëfilltë dhe partneritet midis të rinjve dhe organet vendore dhe rajonale dhe duhet t'u mundësojnë të rinjve dhe përfaqësuesve të jenë aktorë të plotë në politikat që i prekin ata. Strukturat e tilla normalisht duhet të jenë përfaqësuese dhe të përhershme dhe të merren me të gjitha çështjet për të cilat të rinjtë shprehin interes. Përveç kësaj, mund të parashikohet krijimi i një strukture ad-hoc për ndonjë debat ose veprim rreth një çështje specifike. Në raste të caktuara mund të jetë e përshtatshme të kombinuarit e formave të ndryshme.

III.1 Këshillat e rinisë, parlamentet rinore, forumet rinore

59. Pjesëmarrja efektive e të rinjve në çështjet vendore dhe rajonale duhet të bazohet në vetëdijen e tyre mbi ndryshimet shoqërore dhe kulturore që ndodhin brenda komunitetit të

tyre, dhe kërkon një strukturë përfaqësuese të përhershme siç është këshilli rinor, parlamenti rinor apo forumi rinor.

60. Një strukturë e tillë mund realizohet me anë të zgjedhjes, ose me emërime brenda organizatave të të rinjve dhe/ose mbi baza vullnetare. Anëtarësia e saj duhet të pasqyrojë përbërjen shoqërore të komunitetit.

61. Të rinjtë duhet të marrin përgjegjësi direkte për projektet dhe të luajnë rol aktiv në politikat përkatëse. Për këtë qëllim, organet vendore dhe rajonale duhet të krijojë apo të mbështesin strukturat për pjesëmarrje aktive.

62. Këto struktura sigurojnë kuadrin fizik për shprehjen e lirë të të rinjve lidhur me shqetësimet e tyre, veçanërisht për sa i përket ngritjes së shqetësimeve të tilla tek autoritetet dhe mundësinë për të bërë propozimet e tyre. Çështjet që do të ngrihen mund të reflektojnë çështjet e parashikuara në pjesën I të kësaj Karte.

63. Rolet e një strukture të tillë mund të përfshijnë:

i. ofrimin e një forumi për shprehje të lirë të të rinjve për shqetësimet e tyre që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me propozimet dhe politikat e autoriteteve;

ii. ofrimin e mundësisë për të rinjtë që të bëjnë propozime tek organet vendore dhe rajonale;

iii. mundësimin e organeve të konsultohen me të rinjtë për çështje specifike;

iv. ofrimi i një forumi ku zhvillohen, monitorohen dhe vlerësohen projektet që përfshijnë të rinjtë;

v. ofrimin e një forumi për të lehtësuar konsultimin me shoqatat dhe organizatat e të rinjve;

vi. lehtësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në organe të tjera konsultative të organeve vendore dhe rajonale.

64. Duke i dhënë të rinjve mundësi të flasin dhe të veprojnë për problemet që kanë të bëjnë me ta, struktura të tilla ofrojnë trajnime për jetën demokratike dhe menaxhimin e çështjeve publike.

65. Prandaj, të rinjtë duhet të inkurajohen të marrin pjesë në strukturat të tilla dhe aktivitete të ndërmarra brenda kornizës së tyre, në mënyrë që të promovojnë kapacitetet e tyre për t'i mësuar dhe vënë në praktikë parimet e qytetarisë demokratike. Veçanërisht për ata të rinjtë të cilët janë nxitësit e projekteve dhe të dialogut me autoritetet, strukturat e tilla duhet të ofrojnë një forum për trajnim për udhëheqjen demokratike.

66. Organet vendore dhe rajonale, si dhe vetë të rinjtë duhet të përfitojnë po ashtu nga efekti i shumëfishtë që mund të sjellë akti i pjesëmarrjes së të rinjve në struktura të tilla, sidomos në drejtim të inkurajimit të të rinjve në ushtrimin e të drejtave të tyre qytetare, siç janë pjesëmarrja në zgjedhje dhe në format e tjera të votimit, duke përfshirë referendumet.

III.2 Mbështetja për strukturat e pjesëmarrjes së të rinjve

67. Që të funksionojnë në mënyrë efektive, strukturat institucionale të pjesëmarrjes së rinisë (si formale ashtu edhe joformale) kërkojnë burime dhe mbështetje. Për këtë arsye, organet vendore dhe rajonale duhet t'u sigurojnë strukturave të tilla hapësirë, mjete financiare dhe mbështetje materiale të nevojshme për të siguruar funksionimin e tyre të mbarë dhe efektiv. Sigurimi i mjeteve të tilla nuk i përjashton strukturat e tilla për të kërkuar mbështetje shtesë financiare dhe materiale nga burime të tjera, siç janë fondacionet private dhe kompanitë.

68. Organet vendore dhe rajonale duhet të sigurojnë se garantohen dispozitat e mbështetjes për strukturat e pjesëmarrjes së të rinjve. Për këtë qëllim, ata duhet të emërojnë një garantues, një person apo grup personash, për zbatimin e masave të mbështetjes, të cilëve do të mund t'u drejtohen strukturat në rast nevojë.

69. Ky person ose ky grup personash duhet të jetë i pavarur nga strukturat politike dhe nga strukturat e pjesëmarrjes së të rinjve, dhe emërimi duhet të rrjedhë nga marrëveshja në mes të dy palëve të lartpërmendura.

70. Përveç garantimit të mbështetjes së sipërpërmendur, funksionet e këtij personi (personave) mund të përfshijnë:

i. të vepruarit si ndërmjetësues në mes të rinjve dhe të zgjedhurve lokal si dhe përfaqësuesve rajonal për ndonjë çështje të ngritur prej secilës palë;

ii. të vepruarit si avokat për të rinjtë kundrejt organeve vendore dhe rajonale në situatat e tensionit ndërmjet këtyre palëve;

iii. të vepruarit si një urë përmes të cilit organet vendore dhe rajonale mund të komunikojnë me të rinjtë;

iv. përgatitjen e raporteve të rregullta mbi vëmendjen e të rinjve dhe të organeve vendore dhe rajonale për të vlerësuar nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën lokale dhe rajonale, për shembull, përmes zbatimit të projekteve ose përfshirjes së të rinjve në strukturat e pjesëmarrjes, dhe ndikimit të pjesëmarrjes së tyre.

**Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës
Këshilli i Evropës**

F – 67075 Strasbourg Cedex
Tel. : + 33 (0) 3 88 41 20 00
Fax. : + 33 (0) 3 88 41 27 51 or 37 47
Internet : <http://www.coe.int/cplre>
E-mail : webcplre@coe.int